

Standardi puro Serb me titull “**Rregullore për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren për shenjimin dhe etiketimin e produkteve të tekstilit**”.

Ky standard **7 faqësh**, sipas Rregullores Nr. 1007/2011 të BE-së, kërkon që etiketimi të tregojë përbërjen e fibrave të produkteve të tekstilit, sipas kontrolleve që bëhen mbi konformitetin e këtyre produkteve.

Në objektiv është transpozimi i Rregullores së deleguar të Komisionit Evropian 2018/122 të 20 tetorit 2017, e cila ndryshon shtojcat I, II, VI, VIII dhe IX të Rregullores Nr 1007/2011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi emërtimet e fibrave tekstile dhe etiketimet përkatëse.

Afati i fundit për marrjen e komenteve është **25-12-2019**.

Ky njoftim realizohet në kuadër të njoftimit të operatorëve ekonomikë që mund të kenë interesa tregtare me shtetin serb lidhur me këtë kategori produktesh, të cilët mund të paraqesin komentet e tyre.